REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep 2-0/DPK
Nr. Prot 01-4935/15
Data 29-12-2015
04
PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	28.12.2015
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Avni Gashi, Drejtor i Prokurimit në Ndërmarrjen Publike Kompania e Ujësjelllësit Rajonal Prishtina
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Gashi,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 pika 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, në rastin kur Operatori ekonomik i cili mund të aplikoj për fitim të kontratës me titull Sigurimi i Automjeteve të KUR – Prishtina ka të punësuar Kryesuesin e Bordit të Ndërmarrjes Publike KUR – Prishtina në departamentin juridik të kësaj ndërmarrje private. Në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Neni 6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është paraparë nocioni i konfliktit të interesit i cili përcakton se "konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik", ndërsa neni 4 i këtij ligji ka përcaktuar kategorinë e zyrtarëve të lartë publik, të cilët i nënshtrohen këtij ligji.
Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit Nr.04/L-051, ka parapa kufizime, dhe ndalesa për zyrtarët e lartë, në situatë kur mund të ketë ose mund të shfaqet konflikti i interesit.

Po ashtu në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Nr.04/L-051, në nenin 4 të këtij Ligji, janë të përcaktuar kategoria e zyrtarëve të lartë publik, dhe Anëtarët e Bordit të Ndërmarrjeve Publike janë zyrtar të lartë publik dhe i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të këtij Ligji.

Neni 7 i Ligjit për PKI ka përcaktuar parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit të lartë, ndërsa në paragrafin (1, 3 5, 6, 8), ndër të tjera thuhet:

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejt që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar.
Zyrtari i lartë duhet ta kryej punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit të lartë dhe institucionit dhe me punën e tij të rrisë besimin qytetarëve në institucione.
Zyrtari i lartë nuk ka të drejt të shfrytëzojë funksionin publik për përfitim të kundërligjshëm për vete apo për të tjerët.
Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejt të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje.
Zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm.

Po ashtu, neni 9 i Ligjit për PKI ka përcaktuar Veprimet e ndaluara për zyrtarin e lartë, në paragrafin (1,,4,5,6,7,,9,), të këtij neni ndër të tjera thuhet se zyrtarit të lartë publik u ndalohen këto veprime:

Të kërkojë apo pranoj shpërblim, premtim shpërblimi lidhur me veprimin e ndërmarr apo mosveprimin që është i obliguar ta ndërmerr në kuadër të ushtrimit të funksionit publik.
Të ndikojë në vendimin e ndonjë zyrtari apo organi për arsye të përfitimit material personal apo personit në lidhje me të.
Të premtojë punësim apo ndonjë të drejt tjetër në ndërrim për dhuratë apo dhuratë të premtuar.

Të ndikojë në marrje - dhënie të punëve apo furnizimeve publike për përfitime personale.
Të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime personale apo për përfitime të personave të afërt apo te besueshëm.
Të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo te besueshëm.

Ne kuader të rregullave qe kan te bejn me fushen e funksionimit të Ndermarjeve Publike, Kodi Etik për Qeverisje Korporative në numrin 7 e ka rregulluar konfliktin e interesit për Ndërmarrjet Publike, në të cilin shprehimisht thuhet :

Vendimet biznesore duhet të bëhen për të mirën e interesave të Ndërmarrjes dhe kurrë nuk duhet të motivohen nga interesat apo përfitimet personale. Andaj nga çdo drejtor dhe i punësuar pritet të mbajë një shkallë të lartë të integritetit në udhëheqjen e biznesit të Ndërmarrjes dhe të ketë mendim të pavarur. Kjo mund të arrihet vetëm me mënjanimin e konfliktit të interesit.

Një konflikt interesi paraqitet kur interesat personale të individëve ndërhyjnë ose bien ndesh në ndonjë mënyrë ose duket se ndërhyjnë apo bien ndesh me interesat e Ndërmarrjes. Një situatë e konfliktit të interesit mund të paraqitet kur një punëtorë ose drejtor, ndërmerr veprime ose ka interesa (familjare, financiare, politike dhe sociale), që mund ta bëjnë të vështirë përmbushjen e punës së Ndërmarrjes në mënyrë objektive dhe efikase. Gjithashtu një konflikt i interesit mund të paraqitet kur një i punësuar ose anëtar i familjes së tij/saj pranon përfitime personale jo të duhura si rezultat i pozitës së tij/saj në Ndërmarrje, pa marrë parasysh nëse ato përfitime janë pranuar në mënyrë direkte apo indirekte.

Ndërsa, neni 65 (paragrafi 1) të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik shprehimisht thuhet se:

Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:

Ka qenë pjesëmarrës në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit, ose në përgatitjen e ndonjë pjese të tyre, që shfrytëzohet nga autoriteti përkatës kontraktues; ose
Ka pranuar ndihmë për përgatitjen e tenderit ose kërkesës për pjesëmarrje nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e njoftimit të kontratës ose dosjes së tenderit ose të ndonjë pjese të ndonjë pjesë të këtyre të fundit.

Përveç këtyre dispozitave, Ligji i Prokurimit ka paraparë edhe kufizime tjera të cilat janë si vijon:

Neni 7, paragrafi 5: *Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.*

Sipas nenit 21, paragrafi 2, të Ligjit të Prokurimit thotë: *Gjithashtu, të gjitha informatat në lidhje me përllogaritjen specifike ose të përgjithshme të vlerës së një kontrate publike ose një konkursi*

të projektimit, si dhe të gjitha informatat mbi fondet në dispozicion për financimin e kontratës ose konkursit të projektimit, nuk duhet të zbulohen para asnjë personi deri në përmbylljen e aktivitetit të prokurimit.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, ju rekomandojmë që të veproni konform rregullave dhe parimeve të përshkruara në këtë Opinion që të parandaloni gjdo situatë të konfliktit të interesit.

Me respekt!